



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8738, datë 12.02.2001 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”

Marrin pjesë: Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia, Spartak Braho.

Mungojnë: Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Tom Doshi,

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëdita!

Kuorumi është i plotësuar, kështu që mund të fillojmë mbledhjen e komisionit.

Pika e parë e rendit të ditës është projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8738, datë 12.02.2001 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, nismë e deputetëve: Petrit Vasili, Spartak Braho, Robert Bitri, Vangjel Tavo, Gledion Rehovica, Bujar Derveni, Përparim Spahiu dhe Gjovalin Kadeli.

Për ta paraqitur këtë nismë të grupit të deputetëve, është i pranishëm zoti Braho.

Zoti Braho, ju lutem një paraqitje të iniciativës së grupit të deputetëve ku përfshiheni edhe ju!

Më pas flet relatori dhe kush mund të ketë pyetje dhe diskutime.

Spartak Braho - Faleminderit!

Siç jeni në dijeni, para disa kohësh ne miratuam Kodin e ri Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Ky kod ka njohur dhe ka pranuar edhe më parë konceptin e ndihmës së parë në rastet e aksidenteve rrugore, por me ndryshimet e pësuara më pas ky koncept është shfuqizuar. Prandaj, është e nevojshme një rishikim dhe rivlerësim për futjen e këtij koncepti, pasi kjo do të sillte përfitime pozitive për shmangien e pasojave të rënda për jetën dhe rastet në aksidentet rrugore.

Siç dihet, aksidentet rrugore janë një fenomen shqetësues dhe kërkojnë një vëmendje të madhe në përmirësimin e sigurisë rrugore të vendit. Janë të shumtë faktorët që ndikojnë në uljen e këtij fenomeni, por një ndër ta është edhe shpejtësia e reagimit dhe efikasiteti i veprimeve të kryera që në momentet e para.

Ndihma e parë mund të jetë vendimtare për të shpëtuar një jetë. Për këtë arsye është vendimtare që fillimisht për çdo kandidat, i cili aplikon për leje drejtimi që do të përdorë sistemin rrugor, të edukohet dhe të sensibilizohet që në krye të herës për veprimet e ndihmës së parë që duhet të japë në rast të çdo aksidenti.

Programet e formimit për ndihmën e parë do të kenë si qëllim që të zhvillojnë njëkohësisht si aftësitë individuale, ashtu edhe ato kolektive për t’u bërë ballë situatave emergjente. Objektivi kryesor i kësaj ndërhyrjeje ligjore do të sjellë uljen e rasteve me pasoja të rënda për shëndetin në aksidentet rrugore.

Studimet e shumta shkencore kanë provuar se në rast aksidenti, prania e një dëshmitari të aftë që të ndërhyjë si duhet përpara mbërritjes së shërbimeve profesionale të urgjencës rrit shanset e mbijetesës të aksidentuarit dhe se ka të bëjë me një lidhje direkte ndërmjet nivelit të njohurive në librin e parë dhe cilësisë së ndihmës së ofruar.

Për të gjitha këto sa u përmendën më sipër, ky projektligj paraqet rëndësi dhe është e domosdoshme që të miratohet. Këto ndryshime të propozuara me anë të këtij amendamenti, bazuar në nenin 81 shkronja “d” e Kushtetutës kërkojnë nevojën e miratimit me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Projektligji i propozuar nuk sjell asnjë efekt financiar në buxhetin e shtetit, ndaj, duke qenë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin, ju ftojme që ta miratoni.

Pak a shumë bëhet fjalë për këtë propozim: për ndryshim në nenin 187, pika 2 të Kodit Rrugor, kursi i ndihmës së parë për kandidatët për leje drejtimi, ku merren njohuritë e nevojshme për dhënien e ndihmës në rast aksidenti, që zhvillohet nga organizata me veprimtari në fushën shëndetësore të licencuara nga agjenci ndërkombëtare dhe të njohura nga autoritetet e Bashkimit Europian për trajnime në fushën e parë të ndihmës mjekësore.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Faleminderit, zoti Braho!

Relatori ka ndonjë koment përveç atyre që janë shkruar në material?

Vexhi Muçmata - Ne jemi komision për dhënie mendimi. Për ta sqaruar më saktë se çfarë kërkojnë kolegët në iniciativë: kërkojnë ndërhyrje në nenin 121, pika 6 të Kodit aktual Rrugor, ku në pikën 6 thuhet: “Trajtimi për dhënien e shpejtë të ndihmës mjekësore në rast aksidenti bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për Transportin dhe ministrit përgjegjës për Shëndetësinë”. Iniciativa synon që pika 6 e nenit 121 të shfuqizohet dhe te neni 187, te “Mënyra e veprimit në rast aksidenti” të shtohet një pikë, ku kjo ndihmë të ofrohet nga organizata e fushës shëndetësore e licencuar nga agjenci ndërkombëtare dhe të njohura nga autoritetet përkatëse të Bashkimit Europian për trajnime në fushën e ndihmës së parë mjekësore.

Në thelb, ky është ndryshimi që propozohet.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Faleminderit!

Kush ka pyetje? Po, zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi - Unë kam disa pyetje. Pra, siç e tha relatori, ndryshohet neni 121, pika 6, pra shfuqizohet. Me sa kuptoj unë, Kodi Rrugor sot i ka dispozitat që detyrojnë nxjerrjen e akteve që normojnë dhënien e ndihmës së shpejtë dhe nuk është se nuk e ka, siç kuptova nga

relacioni që paraqitet nga propozuesit. Ndërkohë që ndërhyrja bëhet te neni që parashikon mënyrën e veprimit dhe kjo nuk është mënyrë veprimi, por është një parashikim i përgjithshëm se kush duhet ta zhvillojë. Është i saktë ky si konstatim? Pra, neni 187 parashikon veprime, ndërkohë që ky nuk është domosdoshmërisht veprim. Për relatorin e kisha. Kjo është për një parashikim se kush duhet të ofrojë, por nuk janë veprime që kryhen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Kisha disa pyetje të këtij lloji: duke qenë se ne jemi përpara një ndryshimi që propozohet, ndërkohë që ky kod është ndryshuar jo më larg se viti 2012, në mos gabo, mbi bazën e një marrëveshjeje që u arrit në parlament në atë kohë për miratimin konsensual të një seri ligjesh, përfshi edhe Kodin Rrugor, dhe sigurisht që në atë kohë janë parë të gjitha. Një pjesë e propozuesve kanë qenë në atë kohë pjesë e asaj maxhorance konsensuale që bëri këto ndryshime në Kodin Rrugor.

Cili është qëllimi sipas propozuesve? Është liberalizimi i ofruesve të këtij shërbimi apo është vendosja e një dispozite, e cila vë diçka ose dyfishon parashikimin e vënies së normave për dhënien e ndihmës së shpejtë?

Fatmir Xhafaj - Po, faleminderit!

Zoti Braho, urdhëroni!

Spartak Braho - Për hir të së vërtetës, duhet thënë që para vitit 2012 kjo dispozitë ka qenë dhe ngarkonte Kryqin e Kuq Shqiptar që të merrej me këto procedura të përgatitjes profesionale të personave, të cilët licencoheshin me autorizim për të drejtuar mjetet. Kam përshtypjen që në vitin 2012 kjo gjë u harrua ose më saktë u la të rregullohej me një vendim qeverie dhe kështu u bë. Me vendim qeverie, sot, këto procedura rregullohen apo ndiqen nga Kryqi i Kuq.

Duke qenë se është shumë klienteliste, pasi ka pasur përpjekje, por edhe aspirata që këtë procedurë ta merrnin edhe autoshkollat që përgatitin, por që nuk e kanë atë nivel apo atë angazhim në përgatitjen e atij që bën kursin për të marrë lejen e drejtimit, u mendua që të futet në Kod, sepse qeveritë ndryshojnë, ndërkohë që Kodi ka një specifik, sepse do miratim me 84 vota. Qëllimisht u propozua që të vihet ky proces kualifikimi: t'i jepet një organizate, siç thuhet edhe në amendament, e cila të ketë një nivel profesional të kënaqshëm, një organizatë e njohur ndërkombëtarisht dhe që jep garanci për një profesionalizëm të mirë për përgatitjen e personit, i cili merr edhe lejen e drejtimit, autoritet, i cili të jetë i njohur edhe nga strukturat e Bashkimit Europian. Kjo është pak a shumë historia. Mendojmë dhe gjykojmë se duhet rregulluar, duhet bërë ky ndryshim nëpërmjet Kodit Rrugor.

Oerd Bylykbashi - Ndryshe nga sa dëgjova në paraqitje, pra bëhet fjalë për një organizatë dhe jo organizata.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shikoj në dispozitë, nejse. Duke qenë se këtë shërbim sot e ofron Kryqi i Kuq, siç e pranuat edhe ju, pra është e rregulluar me vendim qeverie dhe e ofron një organizatë që është e njohur ndërkombëtarisht, ka kompetencën për ta dhënë me atë cilësi që është deri më sot. Do të doja të dija dy gjëra: së pari, janë pyetur përveç Kryqit të Kuq, grupe të tjera interesi në lidhje me këtë dhe cilat?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, do të doja të dija, si?

Së dyti, a parashikon kjo që mund t'i hiqet Kryqit të Kuq dhe t'i jepet dikujt tjetër me një procedurë qoftë edhe konkurruese?

Spartak Braho - Procedura do të jetë konkurruese. Këtu nuk bëhet fjalë për Kryqin e Kuq, por për të gjitha organizatat, të cilat plotësojnë kushtet e mësipërme, pra kanë të drejtë të konkurrojnë.

Oerd Bylykbashi - Mund t'i hiqet Kryqit të Kuq?

Spartak Braho - Po, edhe mund t'i hiqet.

Oerd Bylykbashi - Po për sa i përket procesit të konsultimit, si është realizuar?

Spartak Braho – Janë thirrur të gjitha grupet e interesit nga propozuesit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Mediu, urdhëroni!

Fatmir Mediu – Kryqi i Kuq është një organizatë, e njohin edhe ndërkombëtarët dhe ka një praktikë, që e ushtron prej shumë vitesh në këtë kuadër. Një futje e re, domethënë një kompeticion, që ne nuk e dimë, se themi ndonjëherë organizata të njohura ndërkombëtarisht, mendoj se certifikimi duhet të jetë nga institucioni shqiptar që të garantojnë vërtet se mund të japin vlerësime, trajnime dhe ndihma të tilla. Kështu që duhet ë fusim kërkesa më specifike te Kryqi i Kuq për të dhënë atë që duhet. Të mos fusim organizata të cilat nuk ofrojnë atë që vërtet kërkojmë ne, sipas projektligjit që është paraqitur, dhe nuk realizojmë dot pastaj as ndihmën e shpejtë dhe as atë që u duhet atyre që drejtojnë mjetet për të njohur elementin e parë të ndihmës së shpejtë.

Fatmir Xhafaj – Cila është pyetja?

Fatmir Mediu – Ishte thjesht një sqarim. Duket që po kalojmë nga një organizatë që e njohim ne, në një organizatë tjetër. Cili është kriteri i vlerësimit?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Braho, urdhëroni!

Spartak Braho – Unë thashë që aktualisht këto funksione i kryen Kryqi i Kuq, por që rregullohet me vendim qeverie. Ka përpjekje nga struktura të tjera për ta monopolizuar, ndoshta edhe me të drejtë, siç janë autoshkollat. Bëhet lobing nga autoshkollat për ta marrë këtë procedurë. Ndërkohë që ka organizata të tjera, ne e njohim Kryqin e Kuq, por themi që ta rregullojmë me ligj, jo me vendim qeverie. Domethënë shmangim një lloj klientelizmi që mund të na krijohet në qoftë se do të jetë me vendim qeverie. Tani ne njohim Kryqin e Kuq. A ka organizata të tjera? Unë nuk njoh organizata të tjera, personalisht. Mund të jetë mungesë e dijenisë sime, por nesër edhe mund të ketë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime?

Po, zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, siç e thashë edhe më përpara ky është një kod, i cili vjen pas një pune serioze të bërë nga institucionet, kaluar nëpërmjet një procesi shumë rigoroz, përfshirë edhe Komisionin e Ligjeve, në një proces konsensual edhe në parlament në vitin 2012. Ky kod është parë të ndryshohet edhe me votat e subjektit politik apo të një pjese të deputetëve, që propozojnë këtë sot, është ndryshuar.

Unë gjykoj se kodet jo më kot parashikohen me shumicë të cilësuar, që të kenë një mbrojtje dhe ndryshimet të jenë të tilla që të vlejné vërtet dhe shtojné diçka. Është një kosto legjislative të ndërhysh në një proces që rregullohet nga një kod dhe duhet të bëhet në mënyrë të atillë që të jetë e pjekur sa më mirë. Jo më kot parashikohet edhe konsulta dhe unë nuk kuptova këtu se çfarë lloj konsulte, si është bërë? A është pyetur Kryqi i Kuq që sot e ofron këtë lloj shërbimi? dhe nuk pashë asnjë analizë që puna e bërë nga Kryqi i Kuq deri më sot nuk ka dhënë efektet e saj.

Sigurisht nuk është detyra kryesore e drejtuesve të automjeteve, por është e shërbimit shëndetësor që të ofrojë ndihmën e shpejtë në mënyrë që të shpëtohen jetët apo dëmi të jetë sa më i vogël në shëndet.

Kështu që në këtë aspekt ajo që unë kuptoj këtu, përveçse është një proces i cili nuk është sipas asaj që do të duhej për të dhënë një ndryshim vërtet me peshë, në një kohë që kodi sot parashikon dispozita dhe aktet nënligjore, vendosjen e rregullave për disiplinimin e kësaj fushe.

Nga ana tjetër, kuptoj që nga një traditë që ne sot e njohim dhe nuk po vendosim rregulla edhe më të forta që e njëjta organizatë me reputacion edhe ndërkombëtar të ofrojë një shërbim akoma më të lartë sipas kërkesave të legjislacionit, por jemi vetëm përpara një

tentative për të hequr Kryqin e Kuq dhe për të vënë dikë tjetër, dhe kjo ka pikëpyetje të një lloj klientelizimi nesër në proces, për më tepër që sot këtu në këtë propozim nuk ka rregulla që thonë si do të bëhen, do të ketë konkurse me çfarë kushtesh etj etj., bie erë te një tentativë për një lëvizje klienteliste më pas. Unë besoj se pavarësisht se jemi komision për dhënie mendimi ne kemi për detyrë që këtë aspekt, stabilitetin e legjislacionit, ta mbrojmë sepse është edhe parim kushtetues. Unë për vete besoj se komisioni duhet të pozicionohet ose të kërkojë më shumë informacion që cila është arsyeja, ose ta votojë kundër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Braho, urdhëroni!

Spartak Braho – Kam përshtypjen se zoti Bylykbashi nuk e ka kuptuar. Në qoftë se ne do ta vinim direkt Kryqi i Kuq, ju do të thoshit pse keni vënë Kryqin e Kuq.

Nuk e ka ligji Kryqin e Kuq, por e ka vendimi i qeverisë, por që të mos jetë në oreksin dhe në humorin e qeverive që ndërrohen, ne themi ta vëmë me ligj. Organizatë më prestigjioze dhe më e përgatitur deri më sot, po jua ripërsëris, është Kryqi i Kuq. Por ne nuk mund ta vëmë Kryqi i Kuq për të mohuar nesër apo pasnesër një organizatë tjetër. E para.

E dyta, ky kod që është në fuqi është miratuar me votat e maxhorancës sepse ju nuk e keni votuar.

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Lëreni vitin 2012. Ndryshimet e reja nuk i keni votuar. Jemi përpara ligjit të Kodit të ri Rrugor që është ky aktual. Prandaj keq të vëmë Kryqin e Kuq, keq të mos e vëmë. Ne kemi gjetur një frazë, e cila nuk është e mirë që të vihet Kryqi i Kuq sepse krijon një problem. Pse Kryqi i Kuq, do të thoni ju. Po themi organizata të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht, i njeh BE-ja. Sot është Kryqi i Kuq, nesër mund të dalin të tjera. Ta lëmë të hapur. Prandaj nuk e di pse e merrni me kaq siklet këtë punë.

Është marrë miratimi edhe i Ministrisë së Transportit, edhe i Ministrisë së Shëndetësisë, edhe i Kryqit të Kuq. Janë marrë të gjitha opinionet.

Ne japim një mendim ashtu siç ka dhënë një mendim Komisioni i Sigurisë, jo si komision përgjegjës. Do ta shqyrtojë edhe Komisioni i Çështjeve Sociale.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? 1 abstenim, 4 kundër.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1, ka pyetje?

Ulsi Manja – Për efekt të teknikës legislative meqenëse neni 121 vjen përpara neni 187 ne propozojmë që neni 1 të bëhet neni 2 dhe neni 2 të bëhet neni 1.

Në qoftë se pika 2 e neni 187 nuk preket, të thuhet në nenin 187 shtohet pas pikës 1 pika 1,1, sepse neni 2 do të rrijë në fuqi. Pra, nuk preket pika 2 e neni 187 aktual.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ulsi Manja – Fjala “zhvillohet nga një organizatë” të bëhet “zhvillohet nga organizata”.

Fatmir Xhafaj – Ka tjetër?

Dakord. Dua të them unë diçka. Koncepti “organizatë” këtu, bëhet fjalë për një subjekt juridik. Atëherë, këtu është fjala për subjekte. Se nuk është organizata, sepse të jep idenë e organizatave jofitimprurëse. Pra, ky është subjekt, sepse në fund të fundit është një biznes. Nuk e thotë dot njeri që nuk është biznes, apo jo.

Kështu duhet thënë “nga subjekte me veprimtarinë në fushën e shëndetësore të njohur etj., etj”.

E dyta që doja të shtoja. Kriteret dhe rregullat për licencimin e subjektit dhe zhvillimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, të marrë përgjegjësi politike Këshilli i Ministrave dhe të përcaktojë kriteret kushtet dhe rregullat që duhet të përfitojë një subjekt që ta gëzojë këtë licencë dhe mënyrën si duhet ta ushtrojë këtë veprimtari.

Janë dakord propozuesit?

Oerd Bylykbashi – Dakord, zoti kryetar, por në qoftë se ky është biznes, në qoftë se paratë që sot mblidhen nga Kryqi i Kuq shkojnë për efekt të Kryqit të Kuq, për ato shërbime që bën ajo organizatë, në qoftë se e shikojmë thjesht si biznes, atëherë do të kemi një kompani private që do të licencohet dhe do të jetë çështje fitimi. Pra, qytetarët do të paguajnë për të pasur një kompani të caktuar. Kurse sot shkojnë për një shoqatë, e cila në rast përmbytjesh, në rast tërmeti etj., ofron batanije tenda. Pra, janë lekë që mblidhen...

Fatmir Xhafaj – Mund ta përcaktojë qeveria. Dakord. Prandaj thashë ta përcaktojë qeveria dhe të marrë përgjegjësinë politike. Sepse edhe sot paguhet me sa di unë kur shkon te Kryqi i Kuq, apo jo. Pagan diçka.

Oerd Bylykbashi – I shkojnë Kryqit të Kuq...

Fatmir Xhafaj – Ta përcaktojë qeveria dhe të marrë të gjithë përgjegjësinë politike për këtë gjë. Sot nuk e kemi në ligj të rregulluar për hir të së vërtetës.

Jemi dakord me këtë ndryshim? Dakord.

Neni 2 u bë neni 1 dhe anasjelltas.

Neni 3? Dakord. Hyrja në fuqi.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? 5 Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

E mbylлим edhe këtë projekt me ndryshimet që ka.

Kalojmë në projektligjin “Për lojërat e fatit”.

Ka ardhur ministri? Dakord.

Shtyhet mbledhja dhe do të bëhet kur të jetë ministri i pranishëm.

(Mungesë incizimi.)

Vasilika Hysi – Jam dakord me rezolutën, por të bëhet një redaktim te pjesa e dytë, ku flitet që “Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2014”... Të hiqet nëpër paragrafë, ngaqë e kemi thënë që në krye të paragrafit kryesor. Pjesa tjetër është e rregullt.

(Mungesë incizimi.)

Komisioni do të mbledhet ditën e premte në orën 10:00, meqenëse e hëna është pushim do të diskutojmë ligjin për energjinë dhe ligjin për lojërat e fatit. Ditën e premte në orën 10:00.

MBLEDHJA MBYLLET